

LIGJI Nr. 05/L -141

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L -261 PËR VETERANËT E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-261 PËR VETERANËT E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Neni 2

Neni 15 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

Neni 15
Realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione

1. Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.
2. Veterani Luftëtar i UÇK-së i cili gjatë luftës nuk ka vepruar në Kosovë, nuk gëzon të drejtën në pension.
3. Përrjashtim nga ky nen bën pjesë logjistika që ka vepruar në pika furnizimi në Shqipëri dhe vendet fqinje.

Neni 3

1. Neni 16 i ligjit bazik paragrafi 4 riformulohet si në vijim:

4. Të drejtën në përfitim financiar e ka vetëm Veterani Luftëtar i UÇK-së, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 4

1. Pas nenit 16 të ligjit bazik shtohet një nen i ri si në tekstin në vijim:

Neni 16 A

1. Kategorizimi i Veteranit luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe beneficioneve të tjera, përcaktohet në përputhje me kohën e mobilizimit dhe shërbimit në UÇK, si në vijim:

1.1. Kategoria e parë, Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar nga viti 1991 deri më 5 mars 1998 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

1.2. Kategoria e dytë, Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë pas datës 5 mars 1998 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

1.3. Kategoria e tretë, Veterani luftëtar i UÇK-së, i mobilizuar në luftë pas datës 31 mars 1999 dhe ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës, si dhe Veterani luftëtar i UÇK-së, i angazhuar në luftë nga viti 1991, përkatësisht pas 5 mars 1998, por që nuk ka qenë aktiv deri në ditën e përfundimit të luftës.

2. Buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit.

3. Skema e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, zbatohet pas kategorizimit përfundimtar.

3.1. Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është parapare me ligjin bazik.

4. Pensioni mujor i Veteranit luftëtar, sipas kategorive, është:

4.1. Kategoria e parë, dyqind e pesëdhjetë (250) euro;

4.2. Kategoria e dytë, njëqind e shtatëdhjetë (170) euro;

4.3. Kategoria e tretë, njëqind e njëzet (120) euro.

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Veteranët e Luftës së UÇK-së, të cilët punojnë jashtë institucioneve që paguhen nga Buxheti i Kosovës, si dhe jashtë ndërmarrjeve publike, do të gëzojnë pensionin njëtrajtshëm sipas paragrafit 4 të këtij neni, deri në 50% të shumës së paraparë, por, që në total nuk do të kalojë buxhetin prej 0,7% të Bruto Prodhimit Vendor.

6. Në rast të tejkalimit të 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor, atëherë reduktimi i pensionit ndodhë në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj.

Neni 5

1. Neni 18 i ligjit bazik, fshihet.

Neni 6

Neni 21 i ligjit bazik, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin në vijim:

Lartësia e pensionit të trashëgimitarit të Veteranit Luftëtar sipas këtij ligji është dyqind e pesëdhjetë (250) euro.

Neni 7

1. Pas nenit 40 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 40 A si në tekstin në vijim:

Neni 40 A

Komisioni për kategorizimin e veteranëve luftëtarë

1. Me këtë ligj themelohet Komisioni për kategorizimin e Veteranit Luftëtar të UÇK-së, sipas kategorive të cekura në nenin 16A, duke u mbështetur në të dhënat që gjenden në dokumentet në bazë të të cilave është bërë aplikimi dhe i'u është njohur e drejta në statusin e Veteranit të Luftës së UÇK-së.

2. Komisioni do të përbëhet nga përfqësusit e ZKMZCVL, MPMS-së dhe përfaqësuesit e OVL-së.

3. Funkcionimi, organizimi, puna dhe procedurat e procesit të kategorizimit të Komisionit, do të rregullohen me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-141

30 dhjetor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-016-2017, datë 11.04.2017 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.